

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË, Departamenti i përgjithshëm-Divizioni penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Minir Hoti dhe sekretaren juridike Fatmire Podvorica, në çështjen penale kundër të akuzuarit A. Xh. Ç. nga fshati B., komuna e P., për shkak të veprës penale në bashkëkryerje me të miturin F. Ç. Vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 nën par.1.1 të KPRK-së dhe veprën penale Marrja apo asgjësimi i vulave zyrtare ose i shkresave zyrtare nga neni 415 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP.nr.194/2015 të dt.30.03.2015, në shqyrtimin fillestar publik të mbajtur në praninë e prokurorit të shtetit Ibrahim Fejza nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, të akuzuarit A. Ç. si dhe mbrojtësit R. F., avokat nga P., i caktuar sipas detyrës zyrtare, të njëjtën ditë më datën 14.04.2015 mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari: **A. Ç.**, nga babai Xh., dhe nënës H., e vajzërisë M., i lindur më *data e lindjes...* në fshatin B., komuna e P., nr. personal *numër personal...*, i pa martuar, ka të kryer shkollën fillore, me profesion punëtor ndërtimtarie, i gjendjes së dobët ekonomikore sociale, Shqiptarë, Shtetas i Republikës së Kosovës, **gjendet në paraburgim nga data 15.03.2015 e tutje.**

Ë S H T Ë F A J T O R Ë

Sepse:

I. Më dt.13.03.2015, rreth orës 19:10, në fshatin B., Komuna P., i pandehuri në bashkëkryerje me vëllain e tij-të miturin F. Ç., me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të pasurisë së luajtshme me përdorimin e forcës-duke hapur dritaret në mënyrë të dhunshme nga ana e pasme kanë depërtua në brendi të objektit duke dëmtuar dy dyer të banjove të shkollës si derën e zyrës-sallës së arsimtarëve të shkollës fillore “E. D.”, të fshatit B., komuna P., ku me atë rast kanë demoluar orenditë dhe sendet tjera të cilat ishin në sallën e arsimtarëve, ku marrin një kasetofon dhe disa “CD”, të cilin e fshehin afër shtëpisë së tyre, të cilin më vonë e sekuestron policia,-

- me çka në bashkëkryerje me të miturin F. Ç. ka kryer veprën penale Vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 nën par.1.1 të KPRK-së.

II. me datë, kohë, vend dhe mënyrë siç është përshkruar në dispozitivin e parë të kësaj aktakuze i pandehuri ka marrë tre ditar-regjistra të nxënësve dhe atë: një të klasës së 8 (tetë) dhe 2 (dy) të klasës së 6 (gjashtë), të cilët përmes një dritareje i ka gjuajtur jashtë objektit dhe më pastaj që të tre ditarët i ka asgjësuar duke i djegur në oborrin e kësaj shkolle,-

- me çka ka kryer veprën penale Marrja apo asgjësimi i vulave zyrtare ose i shkresave zyrtare nga neni 415 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në bazë të neneve 7, 17, 41, 45, 46, 73, 74, 75, 76 dhe 83 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPRK-së, i:

P Ë R C A K T O N

Për veprën nën pikën **I.** të dispozitivit, e dënon me dënim me burgim në kohëzgjatje prej **7 (shtatë) muajsh**, si dhe me dënim me gjobë në shume prej **200 Euro, (dyqind euro)**.

Për veprën nën pikën **II.** të dispozitivit, e dënon me dënim me gjobë në shumë prej **400Euro, (katërqind euro)**.

Andaj gjykata duke u bazuar ne dispozitën e nenit 80 par.1 dhe 2 nën par.2.4 të KPRK-së, e:

GJYKON

Te pandehurin **A. Ç.** me dënim me burgim në kohëzgjatje prej **7(shtatë) muajsh**, të cilin dënim do ta mbajë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, si dhe me dënim UNIK me gjobë në shumë prej **600 Euro, (gjashtëqind euro)**.

Nëse i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, atëherë dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim burgimi, ashtu që për çdo 20€ (njëzet euro), të papaguara do t'i llogaritet 1(një) ditë burg.

Pas shpalljes së aktgjykimit të akuzuarit konform nenit 367 par.1 nën par.1.1 lidhur me par.3 dhe par.7 të KPPRK-së, i vazhdohet masa e paraburgimit deri në plotfuqishmëri të aktgjykimit por jo më shumë se koha e dënimit të shqiptuar në aktgjykim.

Konform nenit 83 par.1 të KPRK-së, në dënimin e shqiptuar i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës **15.03.2015 e tutje**.

Detyrohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumë aq sa do të jetë sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës si dhe në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumë prej **50Euro**, (pesëdhjetë euro), brenda afatit prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

E dëmtuara SHFMU "E. D." nga fshati B., Komuna P., përfaqësuesi drejtori B. L., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohen në kontest të rregullt juridiko civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën PP.nr.194/2015 të dt.30.03.2015, ka akuzuar A. Xh. Ç. nga fshati B., komuna e P., për shkak të veprës penale në bashkëkryerje me të miturin F. Ç. Vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 nën par.1.1 të KPRK-së dhe veprën penale Marrja apo asgjësimi i vulave zyrtare ose i shkresave zyrtare nga neni 415 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata duke u bazuar në nenin 242 par.5 të KPPRK-së, mbajti seancën e shqyrtimit fillestar më dt.14.04.2015, gjatë së cilës u dëgjuan prokurori i shtetit I. F. nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, i akuzuari A. Ç. dhe mbrojtësi i të akuzuarit avokat R. F., nga P., i caktuar sipas detyrës zyrtare.

I pandehuri A. Ç. në seancën e shqyrtimit fillestar e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohet sipas të gjitha pikave të aktakuzës si dhe ka theksuar se më vjen keq që kam kryer këto vepra penale dhe i premtoj gjykatës se nuk do të përsërisë vepra të tjera, ndërsa sa i përket kërkesës për vazhdimin e masës së paraburgimit lus gjykatën që kjo masë të ndërprehet.

Mbrojtësi i të pandehurit A. Ç., i caktuar sipas detyrës zyrtare avokat R.F. lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklaroi se pasi që i mbrojturi im është konsultuar me mua dhe ka deklaruar se edhe kur është marrur në pyetje në stacionin e policisë në Podujevë, edhe në Prokurorin e shtetit në Prishtinë, i njëjti ka pranuar se ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet po ashtu edhe gjatë shqyrtimit të sotëm fillestar, ne kishim propozuar që gjykata me rastin e vendosjes lidhur me shqiptimin e dënimit ndaj të mbrojturit tim A. Ç. gjykata të vlerësoj të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në dënimin konform nenit 64 te Kodit Penal të Kosovës, ashtu si rrethanë lehtësuese të marr se i mbrojturi im e ka pranuar fajësinë dhe ndien keqardhje për veprat e kryera, dhe njëherit i premtoj gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryej ndonjë vepër tjetër penale apo vepra tjera të ngjashme, për këtë arsye propozoi që gjykata të pandehurit A. Ç. ti shqiptoi ndonjë dënim sa ma të butë për arsye se i njëjti është i moshe se re, ka premtuar se nuk do të kryej ndonjë vepër tjetër penale, gjendjen ekonomike sociale e ka të rëndë pasi që është punëtor fizik, andaj mendoj se me këtë do të arrihet edhe qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 te Kodit Penal të Kosovës, njëherit propozoi që gjykata të pandehurit t'ia ndërprej masën e paraburgimit i cili është caktuar me dt.15.03.2015, në ora 21,00, për arsye se kanë pushuar të gjitha shkaqet dhe arsyet për të cilat është caktuar.

Prokurori i Shtetit Ibrahim Fejza nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, në fjalën e dhënë lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklaroi se e pranoj pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit për veprat penale për të cilat akuzohet dhe të cilat i ka kryer, konstatojmë se pranimi i fajësisë nga i pandehuri ka qene i vullnetshëm dhe pa imponim, e ne konsultim të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, si dhe ky pranimi i fajësisë mbështet në provat që gjenden në shkresat e lëndës me çka vërtetohet dispozitivi i aktakuzës, duke kërkuar nga gjykata që të pandehurin ta shpalli fajtor dhe të dënoj sipas ligjit.

Gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit.

Gjykata pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit, si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit Ibrahim Fejza, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 248 par.1 të KPPRK-së, dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar gjyqësor, andaj Gjykata konform nenit 248 par.4 të KPPRK-së, nuk ka zbatuar procedurën e provave por ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet i akuzuari, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të të akuzuarit përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 nën par.1.1 të KPRK-së dhe veprën penale Marrja apo asgjësimi i vulave zyrtare ose i shkresave zyrtare nga neni 415 të KPRK-së, e për çka gjykata gjeti se i akuzuari në aspektin penal-juridik është përgjegjës, për çka edhe u shpallë fajtorë.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, Gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 73 të KPRK-së, dhe në rastin konkret si rrethana posaçërisht lehtësuese lehtësuese gjeti faktin se i akuzuari, gjatë shqyrtimit gjyqësor e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprat penale të cilat i vihen në barrë, bashkëpunimin me gjykatën, ishte i sinqertë gjatë gjykimit, gjendjen e tij të dobët ekonomike e sociale, dhe ndjen shumë

keqardhje për rastin si dhe i kërkon falje të dëmtuarve për dëmin dhe përjetimet e pësuar, moshën e tij të re, sjelljen e tij pas këtij rasti, si dhe premtimin se nuk do ta përsëris të njëjtën veprë penale, ndërsa si rrethanë rënduese mori se ndaj tij zhvillohet procedurë penale për vepra penale Vjedhje e rëndë, është recidivist, sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, motivin për kryerjen e veprës, shkallën e rrezikimit apo dëmtimit të së mirës së mbrojtur. Andaj gjykata ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK-së, që të parandaloj kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave të tilla penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjykata duke u bazuar në nenin 74 par.1 dhe par.3, nenin 75 par.1 nënpar.1.2 dhe nënpar.1.3 të KPRK-së ka zbatuar dispozitat për zbutjen e dënimit, ngase i pandehuri është i moshës së re, e ka pranuar fajësinë në shqyrtim fillestarë, ka shprehur keqardhje për veprën që e ka kryer si dhe ka premtuar se nuk do ta përsërisë veprën penale, si dhe është kthyer sendi i vjedhur në këtë rast kasetofoni, andaj të gjitha këto tregojnë se qëllimi i dënimit mund të arrihet edhe me shqiptimin e dënimit më të butë.

Vendimi mbi llogaritjen e paraburgimit në dënimin e shqiptuar u muar në kuptim të nenit 83 par.1 të KPRK-së.

Vendimi mbi zëvendësimin e dënimit me gjobë në dënim me burgim është marrë në kuptim të nenit 46 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor u mor në bazë të nenit 450 par.1 dhe 2 pika 2.1 dhe 2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest civil është marrë në kuptim të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
P.nr.271/2015 më dt.14.04.2015

Gjyqtari:
Minir Hoti

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykate.